

# KOMUNA KALA E DODËS

## Plani Strategjik i Zhvillimit

Përgatitur nga:



Financuar nga:



## Përmbajtja

### Përmbajtja

1. Nevoja dhe rëndësia e Hartimit të Planit Strategjik të Zhvillimit.
2. Profili i komunës
  - 2.1. Pozita gjeografike
  - 2.2. Pak histori
  - 2.3. Popullsia
  - 2.4. Punësimi
  - 2.5. Arsimi
  - 2.6. Shëndetësia
  - 2.7. Ekonomia lokale
    - 2.7.a. Burimet natyrore
    - 2.7.b. Bujqësia
    - 2.7.c. Blegtoria
  - 2.8. Infrastruktura dhe shërbimet publike
    - Rrugët
    - Energjia
    - Uji i pijshëm
    - Kanalet e ujërave të Zeza
    - Shërbimi postar
    - Telekomunikacioni
  - 2.9. Qeverisja vendore
3. Analiza e situatës
4. Vizioni dhe strategjitë sektoriale
5. Procesi i vendosjes së prioriteteve
6. Realizueshmëria



## 1. NEVOJA DHE RËNDËSIA E HARTIMIT TË PLANIT STRATEGJIK TË ZHVILLIMIT

**P**lani strategjik i Zhvillimit të Komunës së Kalasë së Dodës për vitet 2009-2014, është dokumenti më i rëndësishëm dhe themelor në fushën e zhvillimit të komunës dhe në hartimin e planeve me aktivitete specifike zhvillimi.

Si një dokument i tillë, ai identifikon drejtimet strategjike optimale, sasiore dhe cilësore, brenda kuadrit të zhvillimit të komunës, duke marrë në konsideratë hapësirat e mundësive ekonomike që janë të segmentuar. Gjatë procesit të përgatitjes së Planit Strategjik jemi mbështetur për të integruar në të dhe dokumente nga Strategjia e Zhvillimit Rajonal të Qarkut të Dibrës, hartuar nga UNDP në vitin 2005 dhe Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Rural, Strategjinë e Zhvillimit të Turizmit dhe Strategjinë e Reduktimit të Varfërisë në Republikën e Shqipërisë.



Plani Strategjik i komunës së Kalasë së Dodës konsiston në një listë me objektiva kyçe prioritare që janë karakteristike për zonën, duke u përpjekur të zgjidhin problematikën aktuale, të parashtrajnë drejtimet dhe tendencat kryesore për të ardhmen e komunës në harmoni me perspektivën e zhvillimit të gjithë vendit.

Anëtarët e grupeve të punës kanë marrë pjesë aktive në procesin e hartimit të Planit Strategjik. Grupi qendror ka qenë i përbërë nga përfaqësues të Administratës dhe të institucioneve të komunës, nga përfaqësues të biznesit dhe sektorëve të tjerë, si dhe nga përfaqësues të OJF dhe të komunitetit, të cilët punuan sipas principeve dhe normave të metodologjisë së hartimit të planit Strategjik.

Në hartimin e Planit Strategjik të Komunës u asistua nga skuadra e eksperteve të ALPIN (Qendra për Zhvillime rajonale dhe Ekonomike), e cila u financua nga këshilli i Qarkut të Dibrës. Kjo ishte pjesë e financimit që Qarku i Dibrës ka marrë nga Ambasada Holandeze në kuadrin e programit për Forcimin e Qeverisjes së mirë në Rajonin e Dibrës.

Pas diskutimeve me publikun, plani strategjik u diskutua dhe u adaptua sipas rekomandimeve të anëtarëve të Këshillit të Komunës, duke marrë kështu dhe aprovim ligjor, si plani final i zhvillimit të komunës.

Plani strategjik i Zhvillimit të komunës së Kalasë së Dodës do të zbatohet përgjatë realizimit të planit të aktiviteteve. Kjo nënkupton, që në planet vjetore që përgatiten nga kryetari i komunës dhe miratohen nga këshilli i komunës do të jenë sipas drejtimeve dhe gjurmëve të planit strategjik, i cili është i hapur dhe për rekomandime dhe shtesa të reja, sipas nevojës dhe rasteve të krijuara.

## 2. PROFILI I KOMUNËS

### 2.1) POZITA GJEORAFIKE

Komuna shtrihet në veri të rrethit Dibrës dhe ka një sipërfaqe prej 7990 Ha, me një terren kryesisht malor që fillon nga 700 m mbi nivelin e detit deri mbi 2500 m. Nga lindja kufizohet me kufirin shtetëror të Maqedonisë, nga jugu dhe jug-perëndimi me komunën e Sillovës dhe nga Perëndimi me komunën e kalisit dhe Bushtricës së Qarkut të Kukësit. Kalaja e Dodës shtrihet rrëzë malit më të lartë në Shqipëri, mali i Korabit me një lartësi prej 2751 m, me një pamje piktoreske mahnitëse, me pyje, kullota dhe pak tokë bujqësore.


Komuna përbëhet nga 8 fshatra me një popullsi 3550 banorë dhe 825 familje si: Ceren që është qendra e komunës, Vaise, Shulla, Ploshtan, Kullas, Ujë Mirë, Tejez dhe Radomirë. Kalaja e Dodës ndodhet në mes të rrugës Peshkopi-Kukës, 35 km larg Peshkopisë dhe 35 km larg qytetit të Kukësit, rrugë që akoma është rurale por ka përfunduar projekti dhe ka filluar asfaltimi i saj në dy lotet kryesore për një gjatësi rreth 30km. Nga pozita gjeografike dhe kulturore, Kalaja e Dodës ndodhet në pikë lidhjen e krahiënës së Dibrës me atë të Lumës, me Malësinë e Prizrenit, malësinë e Tetovës dhe Gostivarit.

Klima është kontinentale malore, me dimër të gjatë dhe të ashpër, me reshje dëbore përgjatë gjysmës së vitit dhe me verë të freskët e të thatë. Temperaturat shkojnë më e ulta -17°C në dimër dhe më e larta në verë deri në 25°C reshjet e dëbores arrijnë deri 2m duke e bllokuar shpesh zonën.

### 2.2) PAK HISTORI

Kalaja e Dodës, ka një histori të lashtë dhe të lavdishme. Emri kala mendohet se vjen për disa arsye, si nga pozicioni gjeografik që ka në formën e një kalaje, ku mali i Korabit dhe shkëmbinjtë e tjerë duken si murët dhe bedenat e një kalaje natyrore, por dhe nga mënyra e jetesës së komunitetit të kësaj komune, të cilët me marrëdhëniet sociale dhe ekonomike, sjelljen, kulturën, rregullat dhe tradita, e bëjnë një jetesë brenda “kalasë” së tyre të veçantë nga banorët e komuna përreth dhe të krahinave përreth, me të cilat kanë shkëmbime dhe marrëdhënie shumë të mira miqësore, martesore dhe ekonomike. “Itifaqet” kanë qenë forma e qeverisjes dhe vendimarrjes fshatare në çdo kohë, pa e humbur këtë dhe gjatë kohës së regjimit komunist dhe në ditët e sotme.

Banorët e Kalasë, njihen si shtegtare, kjo për arsyen e thjeshtë sepse ata shquhen për mbajtjen e numrit të madh së bagëtisë së imët, dhe për arsyet



klimaterike kanë qenë detyruar të shtegojnë në zonat e ulëta gjatë Dimrit, në fushat e Selanikut dhe të Egjeut në kohët e mëparshme dhe në zonën e Ultesirës perëndimore në Shqipëri. Quhen shtegtare pasi ata gjithmonë kthehen në shtëpinë e tyre. Zona e kalasë shquhet për njerëz punëtorë, bestare, trima dhe bujarë, cilësi të cilat ata i mbajnë kudo që shkojnë, jo vetëm në zonën e tyre. Simbol i trimërisë dhe qëndresës së kalasë kanë qenë kryengritjet e viteve 1913 dhe 1920 kundër Serbëve, ku kanë dhënë jetën shumë banorë të kësaj zone duke mos e lënë që të pushtohej krahina e tyre.

Zona e kalasë së Dodës është shumë e pasur dhe në fushën e Etno-Kulturës. Veshjet tradicionale të cilët ruhen në mënyrë masive dhe në ditët e sotme, gjë që është dalluese në gjithë Shqipërinë si për burrat dhe për gratë, këngët dhe vallet e bukura popullore që paraqesin të gjitha aspektet dhe motivet e jetesës së kësaj popullsie janë një thesar i folklorit të gjallë dhe në ditët e sotme. Ceremonia e dasmave me flamur vazhdon në ditët e sotme dhe nuk ka qenë ndaluar as në kohën e komunizmit. Mënyra e jetesës në shtëpi, pritja e mikut dhe respekti ndaj tij, mënyra e gatimit, si dhe punimi i gurit në ndërtimin e shtëpive vazhdon të jetë tradicionale, e bukur dhe madhështore.

### 2.3) POPULLSIA

Kalaja e Dodës ka një popullsi prej 3550 banorësh e përqendruar në 8 fshatrat e komunës. Lëvizjet demografike të cilat janë karakteristike për rajonin e Dibrës, për komunën e Kalasë kanë qenë të larta. Kryesisht lëvizja ka pasur tendencën drejt qendrës metropolitane në Tiranë e Durrës. Karakteristikë tjetër e komunës së kalasë është lëvizja e njerëzve drejt zonave të ulëta ka qenë e hershme, dhe ata janë vendosur kryesisht në zonat periferike të tyre, ku kanë investuar shumë në ndërtimin e shtëpive të reja dhe të bukura, por ata nuk e kanë lënë dhe Kalanë. Kështu gjate muajve të verës, shumica e tyre kthehen në shtëpitë e tyre në Kala.

#### KARAKTERISTIKAT BAZË TË KOMUNITETIT


Nr	Fshati/ Lagjia	Nr. i banorëve			Nr. i familjeve në vitet		Nr.fam.që marrin ndihmë soc.
		Femra	Meshkuj	Gjithsej	2002	2007	
1	Vasie	176	164	340	77	65	36
2	Shullan	128	134	262	70	60	31
3	Ploshtan	338	390	728	180	177	45
4	Cerren	278	270	548	131	119	59
5	Kullas	130	140	270	60	45	33
6	Ujemirë	147	167	314	82	74	31
7	Tejes	240	267	507	95	94	38
8	Radomirë	242	339	581	130	120	57
	<b>Komuna</b>	<b>1679</b>	<b>1871</b>	<b>3550</b>	<b>825</b>	<b>754</b>	<b>330</b>

### EMIGRIMI

Emigrimi është fenomen për gjithë komunën. Pjesa më e madhe e emigrantëve punojnë në Itali dhe në Greqi por ka dhe emigrantë në shtetet e tjera Europiane dhe sidomos në Angli. Shumë emigrantë janë dhe në Shtetet e Bashkuara, sidomos të arratisur nga regjimi komunist para 1990. Emigrantë janë burimi kryesor i të ardhurave për familjet e tyre, ku çdo familje ka nga 1 ose 2 persona në emigrim.

### 2.4) PUNËSIMI

Popullsia merret kryesisht me, Blektori, Bujqësi, mbledhje Bime aromatike dhe medicinale. Emigrimi është baza më e madhe e punësimit. Kryesisht emigrantët punojnë në Ndërtim, Bujqësi dhe Shërbime. Në komunë janë të regjistruara 18 subjekte private, kryesisht në shërbime dhe tregti si dhe një baxho. Familjarët dalin në treg javor në Peshkopi me produktet e tyre blegtorale të bëra në shtëpi. Një numër i konsiderueshëm me arsim të mesëm dhe të lartë janë punësuar në administratën e komunës, në shkollë dhe në qendra shëndetësore. Nga 754 familje, 330 prej tyre trajtohen me përkrahje sociale dhe rreth 105 familje janë në kushte shumë të vështira ekonomike.



Nr	Sektorët	Nr. i të punësuarve
1	<b>Biznese</b> - 6 dyqane, 3 pika tregtare, 6 lokale, 2 baxho, 1 sharë	<b>18 subjekte</b>
2	<b>Në arsim</b>	<b>40</b>
3	<b>Në shëndetësi</b>	<b>10</b>
4	<b>Në elektrik</b>	<b>3</b>
5	<b>Në administratën e komunës</b>	<b>12</b>
6	<b>Në ujësjellës</b>	<b>5</b>
7	<b>Në ndërmarrjen e rrugëve</b>	<b>3</b>
8	<b>Posta</b>	<b>2</b>

## 2.5) ARSIMI

Në komunën e Kalasë së Dodës arsimimi realizohet nëpërmjet:

- arsimi të ciklit të ulët,
- arsimi nëntëvjeçar,

Sistemi Arsimor është i prapambetur. Mungon fare sistemi arsimor parashkollor, dhe sistemi i mesëm. Kjo bën që shumë fëmijë të cilët nuk kanë marrë njohuri në sistemin parashkollor në atë të ciklit të ulët të vijë pa njohuritë përkatëse, e njeta gjë është dhe për sistemin e mesëm. Shkolla më afërt është 2 orë larg. Kjo bën që shumë fëmijë të ndjekin shkollën e mesme në Peshkopi ose në qytete të tjera, duke



Arsimi	Nr. nxënësve	Nr. mësuesve	Nr. klasave	Raporti Nx/Mësues	Raporti Nxënës/Klasë	Nr. Nxënësve femra	Nr. mësuesve femra
1 Parashkollor	-	-	-	-	-	-	-
2 CU							
3 9-vjeçar	557	35	43	16/1	13/1	243	16
4 Mesëm	-	-	-	=	-	-	-
5 TOTAL	557	35	43	16/1	13/1	243	16

shpenzuar shumë për konvikt dhe shpenzime të tjera. Kjo bën që disa familje që nuk kanë mundësi të mos i çojë fëmijët e tyre në këto shkolla.

## 2.6) SHERBIMI SHENDETSOR

Në qendrën e komunës funksionon Qendra Shëndetësore me shërbim 8 orë. Aty shërbejnë 1 mjekë dhe 8 mami - infermjere. Qendra nuk është e pajisur mirë, nuk ka auto-ambulancë, si dhe nuk ka farmaci dhe shërbim stomatologjik.

Nr	Fshatrat	Personeli		Ambjentet
		Mjek	Infermiere	
1	Vasie		1	
2	Shullan		1	
3	Ploshtan		1	
4	Cerren	1	2	Q.shëndetësore
5	Kullas		1	
6	Ujëmirë		1	
7	Tejes		1	
8	Radomirë		1	
	Komuna		10	

## 2.7) EKONOMIA LOKALE

Ekonomia lokale kryesisht bazohet në burimet natyrore dhe në menaxhimin e tyre në formë tradicionale. Dega kryesore e ekonomisë lokale është blegtoaria, kryesisht banorët e Kalasë së Dodës janë të famshëm për mbatjen dhe mbarështrimin e dhenve. Kjo lidhet me sipërfaqen e madhe të kullotave në fushën e Korabit.

### 2.7.a) Burimet natyrore

Kalaja e Dodës është shumë e pasur me burime natyrore. Mali i Korabit, më i larti në Shqipëri është një mundësi e mirë për zhvillimin e turizmit pasi shumë

pasionantë dhe vizitorë të ndryshëm e frekuentojnë malin dhe ambientin e bukur malor përreth tij, me pyje, livadhe, burime uji dhe liqen.

Kalaja e Dodës ka 935 ha pyje të mbrojtura, me Ahe, Pishë e zezë dhe pishë e bardhë. Këto pyje nuk janë dëmtuar dhe ruhen me fanatizëm nga banorët e komunës. Gjithashtu ka shumë bimë medicinale që rriten në këto pyje.

6267 ha kullota janë një pasuri e madhe për komunën dhe banorët e saj që merren me blegtoari. Gjithashtu ka dhe 426 ha tokë arë për prodhime të ndryshme bujqësore, si dhe 351 ha tokë e refuzuar e cila nuk mbillet.

Kalaja e Dodës është shumë e pasur dhe me burime ujore. Përmendim burimin e ujit të Preshit, i cili furnizon qytetin e Peshkopisë dhe fshatrat e disa komunave me ujë të Pijshëm. Gjithashtu përroi i Veleshicës dhe përrenj të tjerë janë burime të shumta që kanë sasi të mëdha uji për vaditje, hidro-energji etj.

Gjithashtu në Kalanë e Dodës ka dhe burime minerare si gips, baker, inerte për shtrim rrugësh etj.

Fauna e kalasë së Dodës është shumë e pasur, me lloje të ndryshme gjallesash dhe kafshësh e shpendësh. Përmendim ujkun, ariu, dhelpra, lepuri, thëllëza, pëllumbat e egër etj.



Nr	Lloji i burimit	Sasia	I shfrytëzuar	I pa shfrytëzuar
1	Kullota	6267 ha	Pjesërisht	
2	Pyje	935 ha	Pjesërisht	
3	Toke	777 ha	426 ha	351 ha
3	Burimi ujqor i Preshit		Pjesërisht	jo në treg
4	Përrenj për hidrocentrale		8 mullinj	2 kërkesa hidrocentrale
6	Gips		kërkime	jo
7	Baker		Studim kërkim	jo



### 2.7.b) Bujqësia

Bujqësia në komunën e Kalasë ashtu si në të gjithë vendin ka pësuar ndryshime të mëdha gjatë periudhës së tranzicionit. Tradicionalisht nga kulturat bujqësore rriten: Misri, Thekri, Fasulja ndërsa nga drurët frutorë më të përhapur janë: Arra, Gështenja, Kumbulla, Molla, Dardha, Qershia, Lajthia. Gjatë periudhës së tranzicionit e cila u shoqërua me dëmtime serioze të prerjes së drurëve frutorë në atë pjesë që ishin plantacione. Ligji 7501 nuk është zbatuar në komunën e Kalasë, por secili ka marrë pronën e tij të vjetër.

### 2.7.c) Blegtoria

Banorët e kësaj komune shquhen për blegtori, kryesisht në të imta me dhentë, të gjedhet me lopë dhe njëhundurakë me kuajt të cilët përdoren për transport. Gjithashtu fermerët e kësaj zone mbajnë dhe shpendë dhe bletë.

- Fama më e madhe e zonës janë delet, ata njihen për prodhimin e produkteve të qumështit, mishit dhe produkteve të tjera të bulmetit. Sot prodhohet reth 30-40 kv qumësht në ditë, ku janë ngritur 2 \*dy\* baxho për përpunimin e qumështit. Blegtoria në krahasim me bujqësinë mund të konsiderohet sektori që u


zhvillua me ritme më të shpejta gjatë këtyre viteve. Numri i krerëve në përgjithësi ka ardhur duke u rritur nëse i referohemi tabelës që bën një krahasim të vitit 2005 me atë të 2003.

#### STRUKTURA E SIPËRFAQES SË TOKËS

	Kulturat	Njësia për ha	Rendiment	Prodhimi
1	Drithëra buke	65	50	2500
	- misër	50	30	300
	- thekër	10	40	400
2	Tagjira	10	300	18600
3	Patate	62	250	2000
4	Perime	8	200	58200
5	Fargjere	291	300	30300
	- jonxhe e vjetër	101	300	2400
	- jonxhe e re	12	200	3600
	- hasëll	12	300	21900
	- polifike	180	122	

Toka kryesisht është kodrinore, dhe e pjerrët. Pjerrësia shkon 15-40%, duke e bërë të vështirë punimin me mekanike dhe ujitjen. Gjithashtu ajo është dhe e varfër, kjo ka bërë që një pjesë e e saj të mos punohet dhe të kthehet në tokë për kullotë, kryesisht faragjerët dhe misri janë prodhimet kryesore pasi lidhen me ushqim për bagëtinë, por mbillen dhe për nevojat e veta fasule dhe perime.

Klima dhe pozicioni gjeografik e favorizojnë rritjen e mollës dhe cilësinë e saj. Ajo është me shumë aromë dhe e pastër nga sëmundjet.



#### NUMRI I KRERËVE:

Fshati	Dele	njedhundrak	Gjedhe	Shpende	Blete
1 Vasie	1500	50	200	400	30
2 Shullan	1000	50	200	400	30
3 Ploshtan	1300	150	400	650	50
4 Cerren	4000	150	400	600	20
5 Kullas	1500	50	200	350	15
6 Ujemire	3000	50	200	450	40
7 Tejez	4500	150	350	500	50
8 Radomire	3500	150	350	650	40
Komuna	22 000	800	2300	4000	275

## 2.8) INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET

Infrastruktura dhe shërbimet janë pika më e dobët e komunës. Më poshtë do të jepet përshkrimi i tyre, por mund të themi se mungon fare ose është në cilësi shumë të dobët shërbimi që u ofrohet komunitetit. Kjo për disa arsye: një pasi zona është parë si zonë e thellë, nuk janë investuar fonde në këtë drejtim, kanë munguar projektet dhe programet cilësore si dhe terreni është i vështirë dhe fshatrat janë larg nga njëri-tjetri. Këto janë disa nga faktorët.

Cilësia e keqe e shërbimeve është një nga arsyet kryesore për largimin e banorëve nga komuna, për mungesën e investimeve në këtë komunë, dhe për mos shfrytëzimin e pasurive natyrore, sidomos e mundësive turistike.



Nr	Lloji shërbimit	Përshkrimi	Gjendja aktuale
1	Infrastrukturë rrugore	Komuna ka 26 km rrugë që lidh fshatrat me rrugën nacionale, të paasfaltuara. 8.5 km rrugë nacionale, rruga Peshkopi-Kukës, e paasfaltuar.	- E keqe, nuk kalohet gjatë dimrit. - E keqe, kalohet me vështirësi gjatë dimrit.
2	Ujësjiellës	Nuk ka një ujësjiellës për gjithë komunën. Çdo fshat ka linjë ujësjiellësi, jo sipas kushteve teknike, të marra nga burimet më të afërta me kontribut nga vetë fshatarët. Sasia e ujit e vogël dhe nuk përballon nevojat e banorëve. Ka shumë burime ujore që mund të shfrytëzohen.	- E keqe
3	Kanalizimet e zeza	Mungojnë fare. Përdoren gropa septike.	- Shumë e keqe
4	Telekomunikacioni	Nuk ka system fiks, por mbulohet me sistemin e lëvizshëm GSM. Territori mbulohet nga AMC dhe Vodafone.	- Normal
4	Furnizimi me energji	Komuniteti ka ndërtuar vetë kabinat në shumicën e fshatrave. Orari i dritave është i kufizuar, natën nuk ka fare dhe ditën me orar.	- E keqe

## 2.9) QEVERISJA VENDORE

### Struktura e Komunës:

Që më 1991 me ndarjen e pushteteve, kalaja e Dodës është pjesë e nivelit të parë të qeverisjes vendore si komunë. Ajo ka administratën e cila emërohet nga kryetari i komunës i cili zgjidhet me votim të drejtpërdrejtë nga populli si dhe organin vendimmarrës Këshillin Komunal që zgjidhet nga lista emërore e këshilltarëve mbi bazen e përqindjeve që forcat politike që i përfaqësojnë, kanë marrë në votimet për zgjedhjet lokale.

Gjithashtu çdo fshat ka dhe kryetarin e fshatit që

zgjidhet nga përfaqësuesit e çdo lagjeje.

Në vitet e fundit janë krijuar dhe disa shoqata që merren me çështje të caktuara si ajo e pyjeve, ujit të pijshëm apo vaditës etj, si dhe ekzistojnë dhe komisione të ndryshme që merren me një problem të caktuar si i zgjidhjes së konflikteve, i pronave, i xhamisë e tej.

Komuna ka një administratë me 11 punonjës. Kryetari, Zyra e Shërbimeve, Zyra e Financës, Zyra e Bujqësisë, Zyra e Tatim Taksave, Zyra e Ndihmës Ekonomike, Zyra e Administratë -Arkivit, si dhe Policia Komunale.

Këshilli i Komunës përbëhet nga 13 Këshilltare.

### 3. ANALIZA E SITUATËS

#### A. KARAKTERISTIKAT POZITIVE TË ZONËS. AVANTAZHET

- Pasuri të shumta natyrore, peizash i mrekullueshëm malor, me malin më të lartë në Shqipëri, malin e Korabit dhe fushën e tij, janë një mundësi e mirë për zhvillimin e turizmit malor, ekologjik dhe kulturor.
- Kullotat e shumta të fushës së korabit, tradita në rritjen e të imtave janë një mundësi e mirë për shtimin e prodhimit të qumështit dhe mishit, si dhe rritjes së të ardhurave.
- Pyjet dhe bimët medicinale janë burim të ardhurash për banorët.
- Asfaltimi i rrugës nacionale Peshkopi-Kukës, mundëson lëvizjen e shpejtë për në qendrat urbane të Peshkopisë e Kukësit si dhe me Kosovën e Tiranën.
- Ruatja e traditës popullore, në veshje, zakone, në organizim janë karakteristika më fisnike e banorevë të kësaj treve.
- Karakteri punëtor dhe shtegtimi i bën banorët e komunës së kalasë të shfrytëzojnë mundësitë për të rritur të ardhurat dhe zhvilluar duke shfrytëzuar lëvizjen e lirë në vend dhe në Europë.
- Burimet e ujit të Preshit, do të fillojnë të sjellin të ardhura për komunën, pasi ujësjellësat kanë kaluar në varësi të pushtetit lokal. Gjithashtu kanë filluar dhe investime për ujin industrial të gazuar dhe natyral si dhe për birrën
- Burimet e Veleshicës dhe burime të tjera, kanë shtuar interesin e investitorëve për të investuar në Hidro-energji. 2 kërkesa për investim në komunë.
- Vazhdimi i traditës së blegtorisë dhe shtimi i numrit të krerëve të imta me dhen race.



- Banor vendas megjithëse janë të larguar në vende dhe qytete të ndryshme e vizitojnë dhe invetojnë në shtëpitë dhe tokat e tyre në kala.
- Të ardhura të shumta që vijnë nga emigrantët
- Shtimi i fondeve nga qeveria qendrore për vendorët dhe programe e projekte të ndryshme që kanë në fokus zhvillimin e zonave malore dhe atyre rurale.
- Programi i ambasadës holandeze me qarkun e Dibrës ku mund të përfitojë dhe komuna.
- Skema e subvencionit nga ministria e Bujqësisë
- Pozita gjeografike e favorshme për bashkëpunim me komuna të tjera, rajone të tjera dhe me Maqedoninë e Kosovën.



#### B. KARAKTERISTIKAT NEGATIVE. DISAVANTAZHET.

- Cilësia e ulët e shërbimeve në komunë.
- Mungesa e projekteve dhe planeve zhvilluese e rregulluese bashkohore dhe të realizueshme
- Mungesa e investimeve
- Imazhi i keq demagogjik i krijuar nga sistemi i kaluar për zonë e thellë dhe e pazhvilluar.
- Infrastruktura e keqe
- Mungesa e ujit të pijshëm dhe energjisë elektrike.
- Largimi i banorëve nga komuna për në zonat e tjera urbane dhe metropolitane.
- Mungesa e burimeve të mjaftueshme humane, sidomos atyre profesionale.
- Mos pasja e një plani për zhvillimin e zonës dhe për zhvillimin e turizmit.
- Sëmundja e brucelozës për dhentë, ka bërë të ketë probleme për shitjen e produkteve.
- Mos njohja e tregut dhe marketingu jo i mirë për zonën dhe produktet e saj
- Largësia nga tregjet
- Shërbim jo i mirë arsimor dhe shëndetësor
- Kriza ekonomike globale, mund të frenojë investimet e huaja.



## 4. VIZIONI DHE STRATEGJITË SEKTORIALE

### VIZIONI:

Komuna e Kalasë së Dodës në 2013 do të jetë një:

- një zonë e bukur Turistike rrëzë Korabit të lartë, ku pushues e vizitorë nga e gjithë Shqipëria, ballkani dhe vende të tjera Europiane do të vijnë të çlodhen në natyrën e bukur malore, dhe të kënaqen me ushqimin dhe mikpritjen tradicionale, ku banorët vendas dhe të tjerë do të investojnë për Turizmin,
- një njësi administrative e qeverisur mirë, me rrugë të rregulluara, me rrugën nacionale të asfaltuar, me rrjet ujësjellësash të përfunduar në shumicën e territorit, me kanalizime të ujërave të zeza për fshatrat më të mëdha, me shkolla të rregulluara e me kushte normale për mësim, me Ambulanca për çdo fshat dhe me Qendër Shëndetësore ku ofrohet shërbim i kualifikuar dhe në çdo kohë,
- një zonë ku njerëzit do kenë më shumë të ardhura nga blegtoria, turizmi dhe ku janë krenarë për kulturën dhe traditën e tyre.

### ÇËSHTJET DHE SEKTORE KYÇE:

- Zhvillimi ekonomik, fokusuar në zhvillimin e Turizmit dhe blegtorisë
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve publike bazë për komunitetin
- Zhvillimi social, me arsimin, kulturën, shëndetësinë.
- Sigurimi i një qeverisje të mirë lokale.



### OBJEKTIVAT:

1. Sigurimi i zhvillimit ekonomik lokal përmes zhvillimit të blegtorisë dhe Turizmit lokal.
2. Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve Publike për komunitetin e kalasë së Dodës, me ujë, rrugë, kanalizime të zeza etj.
3. Sigurimi i një zhvillimi të kënaqshëm social, me kushte të mira për arsimin, shëndetësinë, kulturën etj.
4. Sigurimi i qeverisjes së mirë lokale, transparente dhe në shërbim të komunitetit.



### STRATEGJIA SEKTORIALE

#### 4.1) Infrastruktura dhe Shërbimet Publike

##### OBJEKTIVI 1:

përmirësimi dhe rehabilitimi i shërbimeve publike dhe infrastrukturës rrugore në Kalanë e Dodës për komunitetin dhe për krijimin e kushteve optimale për zhvillimin e Turizmit.

##### Masat:

- Pregaditja e projekteve teknike sipas standardeve
- Rehabilitimi dhe asfaltimi i rrugës nacionale Peshkopi - Kukës
- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore që lidh fshatrat me rrugën nacionale
- Shtimi dhe sigurimi i investimeve për Ujin e pijshëm.
- Projekte dhe investime për sistemin e ujërave të zeza për disa nga fshatrat më të mëdhenj të komunës.
- Përmirësimi i furnizimit me Energji i popullatës, duke investuar në kabinat dhe burimet e tjera hidrike
- Shtimi i fondeve për mirëmbajtjen e infrastrukturës.



## 4.2) Zhvillimi Ekonomik

Zhvillimi ekonomik shihet në 3 aspekte kryesore:

- zhvillimi i turizmit
- zhvillimi i blegtorisë dhe bujqësisë
- menaxhimi i mire i burimeve natyrore

### OBJEKTIVI 1:

**Rritja në masën 20% e prodhimeve blegtorale në komunën e Kalasë së Dodës.**

#### Masat në Blegtori:

- rritja e rendimentit të prodhimit të qumështit e mishit nga delet, nëpërmjet përmirësimit racor.
- Shtimi i numrit të krerëve dhe matrikullimi i gjithë krerëve të deleve në komunë
- ofrimi i asistencës së nevojshme teknike në komunë, për të luftuar sëmundjen e brucelozës dhe sëmundjeve të tjera.
- nxitja e profilizimit të fermerëve dhe mbështetja institucionale nga komuna për të përfitur nga skema e subvencionit dhe projektet e tjera nga Ministria e Bujqësisë dhe donatorë të ndryshëm.
- Nxitja e përpunuesve të qumështit në komunë dhe mbështetja e tyre për të dalë në treg me emrin e tyre.
- rritja e lobimit dhe promocionit për pozicionimin dhe mbrotjen e prodhimit lokal.



### OBJEKTIVI 2:

**Rritja e të ardhurave nëpërmjet menaxhimit efektiv të burimeve natyrore:**

#### Masat:

- kalimi në pronësi të komunës e pyjeve dhe kullotave që janë në territorin e komunës
- mbështetja e shoqatës së Pyjeve dhe kullotave komunale për zbatimin e planit të menaxhimit
- nxitja e banorëve të komunës për mbledhjen dhe grumbullimin e prodhimeve të dyta të pyllit si bimë medicinale etj.
- Regjistrimi dhe një plan menaxhimi i pasurive dhe pronave që kalojnë në pronësi të komunës,
- Krijimi i kushteve lehtësuese dhe favorizuese për investitorët që do të investojnë në ndërtimin e Hidrocentraleve të vegjël në komunë.



### OBJEKTIVI 3:

**shtimi i përpjekjeve të institucionalizuara për zhvillimin e Turizmit në Komunë.**

#### Masat:

- hartimi i një plani për zhvillimin e turizmit në malin e Korabit
- shtimi i përpjekjeve për promovimin e Turizmit në Korab
- rritja e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit të banorëve të Kalasë dhe biznesmenëve që do merren me Turizëm
- futja e Turizmit si prioritet i kërkesave dhe punës së administratës së komunës dhe aktorëve të tjerë mbështetës.
- Rritja e bashkëpunimit me agjenci dhe organizata që merren me zhvillimin dhe biznesin turistik.
- Krijimi dhe investimi në modele pilote që zhvillojnë Turizmin
- Nxjerrja e rregullave dhe politikave që favorizojnë turizmin nga organet vendimmarrëse të komunës.



#### 4.3) Zhvillimi social

##### ARSIMI

###### **OBJEKTIVI:**

**rritja e cilësisë së shërbimit arsimor për komunitetin e Kalasë.**

###### **Masat:**

- rritja e investimeve për objektet arsimore, godina, mjete, etj
- shtimi i përpjekjeve për profesionalizimin e mësuesve.
- bashkëpunim i mirë me drejtorinë Arsimore për zbatimin sa më të mirë të politikave arsimore në komunë
- nxitja e komunikimit me komunitetin për të kontribuar në rritjen e cilësisë së shkollimit.



#### SHENDETSIA

###### **OBJEKTIVI:**

**rritja e cilësisë së shërbimit shëndetësor.**

###### **Si do të arrihet:**

- rritja e investimeve për godinat dhe infrastrukturën shëndetësore në komunë
- ofrimi i shërbimit shëndetësor me cilësi dhe në kohë për çdo fshat të komunës
- rritja e fondeve dhe kujdesit të komunës për shërbimin në spitalin e komunës
- Përmirësimi i kujdesit ndaj nënës dhe fëmijëve
- Ngritja e konsultoreve në ato fshatra që mungojnë
- Bashkëpunim i mirë me drejtuesit e shëndetit publik në komunë dhe në rajon.



#### 4.4) Qeverisja e mirë Lokale:

###### **OBJEKTIVI:**

**rritja e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve me aftësi profesionale, në kohë duke menaxhuar me efikasitet dhe transparencë fondet publike.**

###### **Masat:**

- Krijimi i kushteve të përshtatshme me ambiente dhe pajisje për stafin e komunës.
- Rritja e aftësive të punonjësve të administratës së komunës dhe vendimmarrësve të këshillit të komunës nëpërmjet trajnimeve nga Njësia e Trajnimit në Qark dhe Organizata të tjera.
- Rritja e pjesëmarrjes së komunitetit në vendimmarrje
- Rritja e bashkëpunimit me të gjithë aktorët mbështetës të qeverisjes në komunë.
- Rritja e bashkëpunimit me komunat fqinje
- Rritja e bashkëpunimit me strukturën Qarkut të Dibrës.

## 5. PROCESI I VENDOSJES SË PRIORITETEVE

Grupet e punës të krijuara gjatë procesit të planit strategjik identifikuan çështjet kritike që lidhen me zhvillimin lokal. Anëtarët e grupit kryesor të planit strategjik kanë bërë një pjesëmarrje aktive në aktivitetet e grupeve të punës në përcaktimin e 28 objekteve nga ku janë përcaktuar 10 projektet më prioritare.

Projektet prioritare janë zgjedhur duke u bazuar në shtatë kriteret:

1. **Impakti në planin operacional dhe me objektivat strategjike**
2. **Realizueshmëria**
3. **Shtrirja në kohë**
4. **Impakti në investime e zhvillim dhe në**

**krijimin e vendeve të reja të punës**

5. **Pjesëmarrja e sektorit privat**
6. **Krahasueshmëria me objektivat dhe projektet e tjera**
7. **Rëndësia specifike e projektit bazuar në vlerësimin e grupeve të punës.**

Për kriteret 1-6, selektimi është bërë me pikë nga 1-4. Grupi i punës praqiti dhe një kriter shtesë (1-3) për projektin që kontribuon më shumë në arritjen e qëllimit për çështjen kritike konkrete.

**Lista e objekteve dhe aktiviteteve prioritare sipas Fushave:**

Nr	Projektet	Fusha	Përgjegjësit	Kostoja	Vlerësimi
1	Ujësjiellësi Cerren-Kroi ftohtë	Shërbime	Komuna me partner FZSH	10 000 000	19
2	Kanali vaditës Sarakan-Ceren.	Bujqësi	Komuna me partner banka Boterore	14 000 000	20
3	Kanali vaditës pugjac-Ploshtan	Bujqësi	Komuna, donator ose FZSH	10 000 000	20
4	Ujësjiellësi Ploshtan-Livadhi Melaxë	Shërbime	Komuna, donator ose FZSH	10 000 000	19
5	Ujësjiellësi Kullas	Shërbime	Komuna me partner FZSH	10 000 000	19
6	Ujësjiellësi Bejzhe-Sauke Kalis	Shërbime	Komuna me partner FZSH	8 000 000	18
7	Ujësjiellësi Dyprejs-ploshtan	Infrastrukturë	Komuna me partner FZSH	7 000 000	18
8	Rruga nga Spitali-Ploshtan	Infrastrukturë	Komuna me partner FZSH	8 000 000	18
9	Rruga Vasie nga shkolla në fund të fshatit	Shërbime	Qarku, komuna, me partner FZSH	8 000 000	18
10	Ujësjiellësi Shulla	Shërbime	Komuna me partner FZSH	7 000 000	17
11	Rrugët e fshatrave që lidhin me rrugën nacionale	Infrastrukturë	Komuna me partner FZSH dhe Buxheti i shtetit	18 000 000	17
12	Rikonstruksioni dhe Pajisja e zyrave të komunës.	Qeverisje	Komuna me partner Qarku dhe Buxheti i shtetit	6 000 000	17
13	Konsultore në fshatrat: - Kullas - Vasie - Cerren	Shëndetësi	Komuna me partner Ministrinë e shëndetësisë, ose Programe te huaja	6 000 000	16
14	Shkolla fillore në: - Kullas-Ujëmire, rikonstruksion-Radomirë - Vasie	Arsim	Komuna me partner Ministrinë e Arsimit dhe Donatorë.	22 000 000	16



Nr	Projektet	Fusha	Përgjegjësit	Kostoja	Vlerësimi
15	Kanalet e zeza në:- Cerren-Kullas - Tejez - Radomire	Shërbime	Komuna me partner FZSH dhe Donatorë të tjerë	30 000 000	16
16	Kanali vaditës Bralice-Shulla	Bujqësi	Komuna me partner Banka Boterore	10 000 000	15
17	Ujësjetësi Livadhi Hoses Xharllak	Shërbime	Komuna me partner FZSH	7 000 000	15
18	Ujësjetësi për çdo lagje dhe fshat	Shërbime	Komuna me partner FZSH	7 000 000	14
19	Plani i zhvillimit të Turizmit	Turizëm	Komuna me partner SNV dhe Buxheti i shtetit	500 000	13
20	Guide turistike për turizmin në Korab	Turizëm	Komuna me partner SNV	500 000	13
21	Festa e Korabit	Turizëm	Komuna me partner SNV dhe Qarku	500 000	13
22	Ndërtimi i 10 hanave në Kala	Turizëm	Komuna me partner Donatore	10 000 000	12
23	Ndërtimi i një pikë Turistike në malin e Korabit	Turizëm	Komuna me partner Donatore	500 000	12
24	Qendër për ski në fushën e Korabit	Turizëm	Komuna me partner Donatore	500 000	12
25	Trajnimi i administratës së komunës	Qeverisje	Komuna me partner SNV dhe Njësia e Trajnimit në Qark	N/A	11
26	Ndërtimi i 2 hidrocentraleve	Energjitike	Bisnesi	N/A	11
27	Vendosja e mullinjve me erë për energji	Energjitike	Bisnesi	N/A	11
28	Qendër për grumbullimin e prodhimeve BIO	Ekonomi	Bisnesi	N/A	11
29	Ndërtimi i një muzeu etnografik në Kala	Kulturë	Komuna me partner donatorë	5 000 000	10
	<b>Totali</b>			<b>247 000 000</b>	

## 6. REALIZUESHMËRIA

**K**y plan është i realizueshëm pasi mbështet mbi objektiva reale dhe mbi gjendjen reale ekzistuese. Ai bazohet mbi opinionet e të gjithë aktorëve potenciale lokale si dhe në modele të suksesshme të propozuar prej tyre. Gjithashtu në konsideratë janë marrë dhe opinione të specialistëve, Objektivat e Mijëvjeçarit dhe Strategjia Kombëtare e Zhvillimit.

Plani synon të realizojë çështjet kritike që lidhen me:

- **zgjdhjen e problemeve emergjente** nëpërmjet shtimit të investimeve në përmirësimin e infrastrukturës dhe të shërbimeve bazë për komunitetin.
- **Zhvillimin ekonomik lokal**, nëpërmjet nxitjes dhe mbështetjes së fermerëve për rritjen e prodhimit të produkteve BIO dhe kultivimin e bimëve medicinale sidomos të sherebelës.
- **Zhvillimin e Burimeve Njerëzore**, që ka të bëjë me Shtimin e masave dhe kujdesit për arsimin, shëndetësinë, kulturën, dhe qeverisjen e mirë të komunitetit.

**Projektet:** Plani parashikon që nëpërmjet 28 projekteve në fushat e infrastrukturës, shërbimeve, bujqësisë, turizmit, burimeve natyrore, arsimin, shëndetësisë, dhe qeverisjes së mirë të arrihen qëllimet dhe objektivat e vëna. Nga këto projekte 10 janë projektet më prioritare të cilat do të kërkohen të realizohen në vitet e para.

**Fondet:** Buxheti i kërkuar për realizimi e këtyre projekteve është afërsisht 142 000 000 lekë. Për 10 projektet prioritare nevojitet një buxhet prej 73 000 000 ky buxhet do të gjendet nga të ardhurat lokale, grandet nga qeveria qendrore dhe investimet nga donatorë të ndryshëm dhe qeveria qendrore.

**Aktorët zbatues:** Kryetari i komunës dhe administrata e tij, janë përgjegjësit kryesorë për zbatueshmërinë e planit. Ata do të hartojnë dhe paraqesin projektet me profesionalizëm para këshillit të komunës në plan buxhetin vjetor, ku do të merret miratimi për zbatimin e këtyre projekteve. Administrata dhe kryetari do të përpiqen të shtojnë të ardhurat dhe investimet nga donatorë dhe grandet qeveritare për



realizimin e këtyre projekteve. Këshilli i komunës do të jetë vendimmarrësi dhe monitoruesi për realizimin e tyre sipas kërkesave të komunitetit dhe kuadrit ligjor.

**Aktorët mbështetës:** Qeveria qendrore, me ministritë e linjës si Ministria e rendit, Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Komunikacionit, Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Mjedisit dhe me drejtoritë rajonale do të jenë mbështetësit kryesorë financiarë me grande dhe me programet e tyre.

Këshilli i qarkut të Dibrës, do të mbështesë nëpërmjet asistencës teknike, nxitjes së bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërkufitar, politikave dhe strukturave rajonale zhvilluese dhe mbështetjes financiare me fonde të dhëna nga donatorë të huaj dhe qeveritare.

**Donatorët: FZSHH** (Fondi i Zhvillimit Shqiptar) me investimet në infrastrukturë, **Banka Botërore** me investimet dhe programet për Bujqësinë, pyjet dhe sektorë të tjerë, **SNV** me asistencën për Bujqësinë, Pyjet dhe Turizmin, **WorldVision** me investimet në fushën e arsimit, **KE** (Këshilli i Europës) me ambasadat e vendeve të tyre dhe me programet e veta në fusha të ndryshme ekonomike dhe sociale janë donatorët e huaj më të rëndësishëm nga të cilët do të priten investime dhe mbështetje për realizimin e planit.

**Aktorët lokalë:** OJF lokale, si ALPIN në fushën e Zhvillimit Rajonal dhe rural, Federata e Pyjeve në fushën e mjedisit, Agritra-Vizion në fushën e sociale dhe ekonomike me fokus gratë rurale, janë organizatat më të konsoliduara që do të ndihmojnë në realizimin me profesionalizëm të planit.

Fermerët, biznesmenët vendas dhe të huaj, dhe komuniteti në tërësi janë investuesit dhe përfituesit kryesorë për realizimin e planit strategjik.